



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 24 shtator 2021

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve

Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit” ose “Paneli”, dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (përkatësisht, “Kërkesa” dhe “ZPS”) me anë të së cilës kërkon tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve për përgjigjet e pritshme të saj ndaj katër apeleve të Mbrojtjes kundër Vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi mocionet paraprake që ngrenë kundërshtime lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara (përkatësisht, “Apelet e Mbrojtjes” dhe “Vendimi i Kundërshtuar”).² ZPS-ja kërkon të përdorë 4.000 fjalë shtesë në secilën prej përgjigjeve ndaj Apeleve të Mbrojtjes (bashkërisht, “Përgjigjet”), të cilat veç e veç nuk do të jenë më shumë se 13.000 fjalë.³

1. Paneli vëren se neni 46(3) i Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”)⁴ përcakton që përgjigjet ndaj apeleve të ndërmjetme kundër vendimeve mbi mocionet paraprake të parashtruara sipas rregullës 97(3) të Rregullores nuk duhet të jenë më shumë se 9.000 fjalë. Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton që pjesëmarrësit në proces mund të kërkojnë, paraprakisht dhe duke lejuar kohë të

¹ F00015, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 30 gusht 2021.

² F00016, Kërkesë e Prokurorisë për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 22 shtator 2021 (“Kërkesa”); F00010, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021; F00011, Apel i Mbrojtjes së Selimit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021; F00012, Apel i Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021; F00013, Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021 (bashkërisht, “Apelet e Mbrojtjes”); F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

³ Kërkesa, para. 1.

⁴ KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës”).

mjaftueshme, tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve në rast se provojnë se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të veçanta.⁵

2. ZPS-ja argumenton se 29 pikat e apelit të paraqitura në Apelet e Mbrojtjes, rëndësia, kompleksiteti dhe risia e aspekteve të trajtuara në Vendimin e Kundërshtuar prej 98 faqesh, si dhe fakti se secilit prej të Akuzuarve i është miratuar shtim i ngjashëm i numrit të fjalëve deri në 13.000 fjalë për parashtrimin e apeleve përkatëse të tyre, të cilave ZPS-ja duhet t'u përgjigjet, paraqesin arsye të vlefshme për miratimin e Kërkesës së saj.⁶ ZPS-ja më tej parashtron se Kërkesa po bëhet një javë para afatit të zbatueshëm dhe se palëve të tjera nuk do t'u shkaktohet asnjë dëm në qoftë se vendimi mbi Kërkesën merret pa marrë parashtrime të mëtejshme.⁷

3. Për sa i përket parashtrimin në kohë të Kërkesës, Paneli është bindur se Kërkesa, e paraqitur nga ZPS-ja më 22 shtator 2021, është dorëzuar brenda një afati të mjaftueshëm paraprak në kuptim të nenit 36(1) të Udhëzuesit të Punës.⁸

4. Paneli ka parasysh gjatësinë e Vendimit të Kundërshtuar (gjithsej 98 faqe). Paneli gjithashtu është i vetëdijshëm se më parë ka miratuar tejkalime të numrit të lejuar të fjalëve lidhur me Apelet e Mbrojtjes.⁹ Në vendime të veta të mëparshme, Paneli ka pranuar se rëndësia dhe kompleksiteti i çështjeve të ngritura në Vendimin e Kundërshtuar, si dhe risia që ato paraqesin përpara Panelit të Gjykatës së Apelit, përbëjnë arsye të vlefshme për ndryshimin e afateve dhe numrit të lejuar të fjalëve për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.¹⁰

⁵ Shih p.sh. F00009, Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 19 gusht 2021 ("Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve"), para. 1;

⁶ Kërkesa, para. 2.

⁷ Kërkesa, para. 3.

⁸ Shih F00005, Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, 28 korrik 2021 ("Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve"), para. 8 (me të cilin zgjatet afati për t'iu përgjigjur Apeleve të Mbrojtjes deri më 30 shtator 2021). Shih edhe Kërkesa, para. 3.

⁹ Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7.

¹⁰ Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, para. 5; Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 4-5.

5. Megjithëse Paneli thekson se cilësia dhe efektshmëria e parashtrimeve në apel nuk varet nga gjatësia e tyre por nga qartësia dhe logjika e argumenteve të paraqitura, mund të jetë me vlerë që Paneli të marrë parashtrime më të hollësishme nga ZPS-ja se ato që lejohen normalisht, për shkak të rëndësisë së apeleve kundër vendimeve mbi mocionet paraprake lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara.¹¹ Lidhur me këtë, Paneli rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se është në interes të drejtësisë që palët që paraqiten para Dhomave të Specializuara të dorëzojnë parashtrime kuptimplota në apel lidhur me pikat e ngritura në Vendimin e Kundërshtuar.¹² Për rrjedhojë, Paneli konstaton se ekzistojnë arsye të vlefshme që përbëjnë rrethana të veçanta që përlligjin tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve të përcaktuar në Udhëzuesin e Punës. Paneli më tej vlerëson se kërkesa për 4.000 fjalë shtesë për secilën nga Përgjigjet, duke arritur maksimumin e 13.000 fjalëve në secilën nga Përgjigjet, është e arsyeshme në rrethanat aktuale, në veçanti pasi një shtim i ngjashëm i numrit të lejuar të fjalëve është miratuar për Apelet e Mbrojtjes.¹³

6. Paneli rikujton se bazuar në nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, mocioni për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohet pa u dhënë palëve kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin e tyre. Duke mbajtur parasysh afrimin e afatit për t'iu përgjigjur Apeleve të Mbrojtjes,¹⁴ si dhe parashtrimin e ZPS-së se dy prej të Akuzuarve kanë bërë me dije se nuk do ta kundërshtojnë kërkesën e ZPS-së, Paneli është bindur se nuk cenohet e drejta e palëve kundërshtare.¹⁵ Për rrjedhojë,

¹¹ Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 5.

¹² Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 5; Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, para. 5.

¹³ Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7.

¹⁴ Shih më lart, para. 3.

¹⁵ Paneli merr parasysh parashtrimin e ZPS-së se Mbrojtja e Veselit dhe Mbrojtja e Krasniqit kanë konfirmuar *inter partes* se nuk do të kundërshtojnë tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, të kërkuar nga ZPS-ja. Shih Kërkesën, para. 3. Shih edhe Vendimin mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 6 dhe poshtëshënimin 16 (ku theksohet se Veseli i ka dhënë ZPS-së pëlqim paraprak në lidhje me një ndryshim të ngjashëm të numrit të lejuar të fjalëve).

Paneli gjykon se është në interes të drejtësisë që të merret vendim i menjëhershëm lidhur me Kërkesën.

7. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON Kërkesën; dhe

AUTORIZON ZPS-në të dorëzojë Përgjigjet, me jo më shumë se 13.000 fjalë secila, jo më vonë se 30 shtatori 2021.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E premte, 24 shtator 2021

Në Hagë, Holandë